



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr. 1664, datë 28.07.2011**

**Për**

**“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1616, datë 24.06.2011 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a dhe Plus Communication sh.a.”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Elda Topi, në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1616, datë 24.06.2011 “Për fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a dhe Plus Communication sh.a” të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (**Raporti**);
- Projekt Vendim i KD (**Projekt Akti**);
- Dokumentet shkresore të palëve (**Provat, Pretendimet**);

### **BAZA LIGJORE:**

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918

### **K Ë SHILLI DREJTUES:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Vendimi nr. 1616, datë 24.06.2011 i KD të AKEP “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a dhe Plus Communication sh.a”;
2. Shkresa e AMC sh.a nr. 2136/6 prot, datë 12.07.2011, “Pretendimet e AMC sh.a., për procedimin administrativ lidhur me tarifën e terminimit të operatorit mobile Plus Communication sh.a.”;
3. Shkresa e Plus Communication sh.a me nr. 538/1 prot, datë 15.07.2011 (AKEP: nr. 2015 prot, datë 19.07.2011), “Dërgohen pretendimet e Plus Communication në bazë të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1616, datë 24.06.2011”;
4. Korrespondenca shkresore midis palëve,
5. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar,

### **V Ë R E N:**

- I.** Sipërmarrësi Plus sh.a me shkresën nr. 538/1 prot, 15.07.2011 (AKEP: nr. 2015 prot, datë 19.07.2011), “Dërgohen pretendimet e Plus Communication në bazë të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1616, datë 24.06.2011”, argumenton në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:
  1. Plus konsideron si të pa bazuar ankimin administrativ të paraqitur nga AMC për zgjidhjen e mosmarrëveshjes datë 29.04.2011 duke pretenduar rrezimin e ankimit për shkaqet e mëposhtme:

- a) Në zbatim të Vendimit nr. 1505 datë 10.02.2011 “Për miratimin e dokumentit final për orientimin në kosto të tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT” i referohet operatorëve celularë AMC, Vodafone AL, dhe Eagle Mobile të përcaktuar me fuqi të ndjeshme në treg me Vendimet nr. 1210, nr. 1211, nr. 1212, datë 31.03.2010 të ndryshuar;
  - b) Plus, sqaron se sipas Vendimit nr. 1505 nuk gëzon statusin e sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg dhe se vlerat e përcaktuara në tabelën e këtij Vendimi do të shërbejnë si rekomanduese apo orientuese për Plus, deri në momentin që AKEP të dalë me një Vendim zyrtar për shpalljen e Plus me fuqi të ndjeshme në treg;
  - c) Plus konsideron se, nuk ka asnjë argument ligjor apo rregullator që të detyrojë Plus të zbatojë një tarifë specifike terminimi të ndryshme nga ajo e vendosur me anë të Vendimit nr. 1351, datë 31.08.2010 “Për mbylljen e procedimit administrativ për zgjidhje mosmarrëveshje interkoneksioni të filluar me Vendim nr. 1320, datë 28.06.2010 midis sipërmarrësve Mobil 4AL, Albtelcom sh.a, AMC sh.a, Eagle Mobile sh.a dhe Vodafone AL sh.a”, me anë të të cilit AKEP ka vendosur që tarifa e terminimit të thirrjeve në rrjetin e Plus të jetë, 18.9 lek/min dhe 0.59 lek/thirrje, dhe se kjo tarifë do të aplikohet deri më 31.08.2011. Gjithashtu Plus thekson se, pas daljes së Vendimit nr. 1351, datë 4.08.2010 nuk ka ndryshuar asnjë nga kushtet e parashtuara për zbatimin e tarifës së terminimit sipas VKD nr. 1351;
2. Plus thekson se, po ti referohemi marrëveshjes së interkoneksionit të lidhur midis Plus dhe AMC më datë 01.09.2010 sipas nenit 23 të MI, AMC apo Plus kanë të drejtë ti drejtohen palës tjetër për Modifikim të MI në rastë se ndosh një ndryshim thelbësor që përfshin nxjerrjen e akteve detyruese nga organet rregullatore ( neni 23.1.6 i MI). Oferta e re e interkoneksionit është detyruese për AMC, por nuk mund të detyrojë palët e lidhura në një marrëveshje kontraktore, ta zëvendësojnë mënjeherë atë me një marrëveshje të re pa rënë dakort të dyja palët për ndryshimet. Gjithashtu, propozimet për ndryshime duhet të bëhen në përputhje me nenin 23 të Marrëveshjes së Interkoneksionit dhe do të konsistonin në ndryshime të cilat vinin si pasojë e ndryshimit të RIO së AMC, dhe në zbatim të nenit 690 të Kodit Civil, kontrata ka fuqinë e ligjit për palët dhe se çfarëdolloj ndryshimi në të duhet të kryhet vetëm në marrëveshje të ndërsjelltë ndërmjet të dyja palëve;
  3. Plus konsideron se, pretendimi i AMC që Plus të zbatojë një kusht komercial (tarifë terminimi) të caktuar nga AMC në mënyrë të njëanshme, në kundërshtim me kontratën e lidhur midis palëve dhe akteve rregullatore në fuqi;
  4. Plus thekson se, AMC me anë të skresave nr. 2333 prot, dt. 10.05.2011, nr. 2333/2 prot, dt. 03.06.2011, nr. 3045 prot, dt. 17.06.2011, nr. 3466 prot, dt. 11.07.2011, ka refuzuar faturat tatimore të lëshuara nga Plus duke mos respektuar MI;
  5. Për sa më sipër Plus kërkon ndërhyrjen e AKEP duke vendosur rrezimin e kërkesës së AMC sh.a për zgjidhje mosmarrëveshje e datës 03.05.2011;
  6. Gjithashru Plus me anë të shkresës nr. 538/1 prot, datë 15.07.2011 “Dërgohen Pretendimet e Plus Communication në bazë të Vendimit nr. 1616, datë 24.06.2011 të KD të AKEP”, (AKEP: nr. 2015 prot, datë 19.07.2011) në pjesën e dytë të saj, për sa i përket

përcaktimit të tarifës së terminimit në Plus duke filluar nga data 01.09.2011 argumenton si më poshtë vijon:

- Bazuar në statistikat e trafikut të thirrjeve hyrëse dhe dalëse të shkëmbyera midis operatorit Plus dhe operatorëve të tjerë kombëtar mobile, rezulton se trafiku dalës nga Plus është më i lartë se trafiku hyrës nga të gjithë operatorët e tjerë mobile. Plus thekson se asimetria në trafik dalës është një element kyç në përcaktimin e tarifës së terminimit për një hyrës të ri në treg;
- Në lidhje me zbatimin e tarifave të rekomanduara nga AKEP, Plus sqaron se zbaton Vendimin nr. 1351, datë 04.08.2011 sipas të cilit tarifa e terminimit të Plus është 18.9 lek/min dhe 0.57 lek/thirrje deri në Gush 2011, duke filluar nga 01.09.2011 tarifa e terminimit e përlogaritur është 12.92 lek/min (duke konsideruar rekomandimet e AKEP në Vendimin nr. 1505, datë 10.02.2011, ndërsa për operatorët e tjerë mobile është respektuar tarifa e terminimi e përcaktuar nga Vendimi i AKEP nr. 1505, datë 10.02.2011). Plus arrin të mbulojë kostot me të ardhurat nga intrekonksion në zbatim të tarifës së terminimit 18.9 lek/min dhe 0.57 lek/thirrje, por duke filluar nga Shtatori 2011 kostot për Plus fillojnë përsëri të jenë më të larta sesa të ardhurat;
- Plus thekson se, tarifa e terminimit e rekomanduar nga AKEP nuk është në atë pozicion që të mbështesë Plus për të mbuluar kostot e gjeneruara nga trafiku i interkonksionit, sepse asimetria në trafik është ende në atë pozicion sa që asimetria e tarifës së terminimit smund të mbulojë asimetrinë e trafikut;
- Plus konsideron se, e vetmja periudhë ku e ardhura e Plus është më e lartë se kostoja, i referohet periudhës Mars – Gusht 2011 kur Plus ka aplikuar tarifën 18.9 lek/min dhe 0.57 lek/thirrje;
- Plus vëren se, situata e disbalancës së SMS-ve përkeqson më tej situatën në të cilën gjendet Plus në treg sot përkundrejt operatorëve të tjerë Mobile.
- Plus konsideron se nuk përbën asnjë rrezik për operatorët FNT për këto arsye:
  - Tarifa e terminimit të Plus nuk përbën asnjë rrezik për operatorët FNT sepse rritja e tregut të Plus është e pakonsiderueshme;
  - Një tarifë e ulët terminimi tek Plus ka pak gjasa të ndikojë në rritjen e ofertave të operatorëve FNT për thirrjet jashtë rrjetit, pasi këta operatorë kanë një bazë të konsiderueshme klientësh dhe është provuar nga aktiviteti i tyre që fokusi është në tarifën ON net (brenda rrjetit), si për tarifën e përdoruesve fundorë ashtu edhe për ofertat promovionale;
  - Tarifa asimetrike e terminimi të Plus, do vazhdojë të ndikojë në konkurrencë pasi do të mbështesë Plus në rritjen e paketave promovionale konkurruese të operatorëve të tjerë dhe për rrjedhojë për ndryshimin e paketave me pakicë. Gjithashtu ky koncept do të ndihmojë Plus të rrisë ofertën për thirrjet dalëse drejt operatorëve të tjerë ( paralelisht me atë brenda rrjetit), duke rritur bazën e pajtimtarëve;
- Plus vlerëson se, ARPU është një element i rëndësishëm për t’u konsideruar nga AKEP në përcaktimin e tarifës së terminimit në Plus. Niveli i përdorimit mesatar mujor i përdoruesve është tepër i ulët, 40 lek në muajin Maj 2011 dhe 41 lek në

muajin Qershor 2011, përkundrejt 300 lek ARPU i operatorëve të tjerë në treg, gjë që vështirëson situatën financiare të Plus në përmbushje të investimeve të planifikuara për vitet e ardhshme;

- Plus argumentos se bazuar në parimin “*në shërbim të rritjes së konkurrencës në treg*”, Plus hodhi në treg produkte e shërbime me çmime tepër të ulta për të tërhequr përdoruesit, dhe për këtë është vendosur në një pozitë të vështirë pasi reduktimi i çmimeve rrjedhimisht sjell një ARPU më të ulët;
- Plus pretendon, lehtësim nga ana e rregullatorit, për këtë fazë fillestare dhe të vështirë të pozicionimit në treg me qëllim zhvillimin e një konkurrence të drejtë;
- Për sa më sipër Plus, duke i’u referuar kushteve të vështira të tregut të komunikimeve elektronike në Shqipëri, efektet e pakonsiderueshme të asimetrisë aktuale si dhe bazuar në praktikën më të mira të tregut evropian, direktivat të cilat shërbejnë si model për të përcaktuar ndër të tjera edhe politikën për rregullimin e tregut, evidenton rëndësinë e përcaktimit të tarifës së terminimit në Plus si më poshtë:

*“Duke filluar nga data 01.09.2011 tarifa e terminimit në Plus të jetë 18.16 lek për një periudhë të caktuar derisa AKEP të monitorojë tregun dhe ecurinë e rritjes së efektshmërisë së Plus në tregun Shqiptar të komunikimeve elektronike”*

**II.** AMC me shkresën nr. 2136/6 prot, datë 12.07.2011, “*Pretendimet e AMC sh.a., për procedimin administrativ lidhur me tarifën e terminimit të operatorit Mobile Plus Communication sh.a.*” sqaron se:

1. Sipërmarrësi Plus, është kompani që ushtron aktivitet tregtar në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe si e tillë është e detyruar t’i nënshtrohet te gjithë legjislacionit, proceseve rregullatore dhe vendimeve të AKEP si të gjithë kompanitë e tjera celulare;
2. AKEP, me vendim ka aprovuar një “glide path” të tarifave duke filluar nga data 1 Mars 2011;
3. Procesi i nënshkrimit të kontratës së re të interkoneksionit bazuar në RIO të AMC, aprovuar nga AKEP është me një kohë të palimituar deri në përfundimin e autorizimit individual të kompanive. Në lidhje me këtë i kemi kërkuar Plus, të shprehet për pozicionin e tij në se do të ndjekë rekomandimet e AKEP, për marrjen në konsideratë “glide path-in” tonë;
4. AMC, gjykon se edhe pse Plus, nuk ka ende status FNT, normalisht ka monopolin si të gjithë operatorët e tjerë në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin e tij. AKEP ka rekomanduar një “glide path” për Plus që duhet të shërbejë referencë për negociatat për interkoneksion me shoqëritë e tjera të telekomunikacioneve;
5. AKEP me vendimin nr. 1505, datë 10.02.2011, “Dokumentacioni final i orientimit në kosto të tarifave celulare” rekomandon Plus Communication sh.a., të zbatojë tarifën e terminimit 15.93 lekë, duke filluar prej datës 01.03.2011;

6. Sa më sipër niveli i asimetrisë mes AMC dhe Plus, duke filluar nga data 01.03.2011, rezulton të jetë 80%. Këto tarifa janë rekomanduese për operatorin Plus, në mungesë të një statusi FNT në tregun e terminimit, por duhet të shërbejnë si referencë në negociatat për lidhje MI mes Plus dhe operatorëve të tjerë. Asimetria aktuale e tarifave të terminimit midis AMC dhe Plus është në nivelin 114%, i cili është shumë më i lartë se 80 %, sic është propozuar në “glide path-in” e miratuar me VKD nr. 1505, të AKEP. Plus pretendon të mbajë të njëjtën tarifë prej 18.9 lekë/min dhe 0.57 lekë/thirrje, që nga data 01.03.2011, duke mbajtur asimetri 114%, shtuar kësaj edhe aplikim të tarifës për thirrje;
7. Pozicioni i AMC, është se nëse vazhdohet të insistohet në idenë që vendimi i AKEP për orientimin në kosto të tarifave është i vlefshëm vetëm për operatorët me status FNT, atëherë në të ardhmen rrezikohet të krijohet një situatë me vlera shumë të larta të asimetrisë në tarifatat e terminimit, krahasuar me ato të rekomanduara në vendimin e AKEP. Kjo situatë bie ndesh edhe me parimin e reduktimit të asimetrive, deri në eliminimin total të tyre brenda harkut kohor të 4-5 vjetëve, siç është parashikuar nga AKEP;
8. AMC thekson se siç është shprehur edhe më parë asimetria midis operatorëve të rinj dhe të vjetër në treg duhet të jetë në vlera të arsyeshme dhe të justifikuar, si në terma ekonomikë ashtu edhe nga eksperienca e vendeve të BE-së. Diferenca prej 114%, nuk është e arsyeshme dhe as e justifikueshme në çfarëdolloj aspekti të lartpërmendur;
9. Në lidhje me pretendimin e Plus për asimetri të nivelit të tarifave të terminimit mbi 100% (aktualisht 114%) kundrejt AMC, sqarojmë se është i paargumentueshëm në lidhje me legjislacionin e BE-së, të raporteve dhe analizave të kryera nga BEREG dhe ERG (*referencë dokumenti ERG (07) 83 final 080312, ERG's Common Position on symmetry of fixed and mobile call termination rates, pages 86, 87*). Niveli i kërkuar rezulton shumë i lartë edhe në lidhje me periudhën kohore të futjes në treg të operatorit Plus, pasi niveli që përcakton ERG në dokumentin (07) 83 është në mesatare jo më i lartë se 35% për operatorët që kanë hyrë në treg 6-11 vjet më vonë se operatorët e parë ekzistues në fushën e telefonisë celulare (AMC, Vodafone). Ndërsa për vonesat në hyrje në treg nga 3-5 vjet ky nivel asimetrie është 17% më i lartë se tarifatat e terminimit më të ulëta në vendet përkatëse. Në asnjë rast nuk shihen asimetri më të larta se 100%;
10. AMC vlerëson se faktorë të tjerë si kostoja e teknologjisë për të bërë të mundur operimin në treg që mund të justifikojnë nivel të tillë asimetrie nuk qëndrojnë, pasi AKEP ka pasur një asistencë të huaj në ndërtimin e “glide path-it” për kompaninë Plus, i cili ka marrë parasysh të gjithë faktorët të cilët ndikojnë në llogaritjen e tarifave të orientuara në kosto;
11. Plus ka dështuar të kryejë negociatat dhe për rrjedhojë të firmosë MI brenda afateve të përcaktuara në nenin 50 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “ Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, për shkak të refuzimit të këtij operatori për të zbatuar kuadrin rregullator;
12. Plus ka kundërshtuar haptazi zbatimin e vendimit nr. 1505, duke mos njohur si të ligjshme tarifatat që AKEP ka miratuar, dhe këmbëngul që në marrëveshjen e re tarifa e terminimit në rrjetin e tij të jetë 18.9 lekë/min dhe 0.57 lekë/min tarifë thirrje. AMC ka insistuar në për aplikimin e tarifës 15.93 lekë/min pa aplikuar tarifë për thirrje sipas vendimit të AKEP nr. 1505;

13. AMC thekson kjo situatë ka krijuar konflikt në lidhje me faturimin mes palëve dhe njohjen e faturave, pasi brenda datës 5 të muajit pasardhës palët në përputhje me ligjin për TVSH dhe dispozitave të RIO, duhet të shkëmbejnë faturat e shërbimeve të interkoneksionit;
14. AMC konsideron se Plus me anë të kthimit të përgjigjeve me email të cilat janë dërguar në AKEP ka refuzuar të pranojë tarifën prej 15.93 lekë/min duke filluar nga data 01.03.2011-31.08.2011, sipas përcaktimeve të AKEP;
15. AMC sjell në vëmendje të AKEP, VKD nr. 1351, datë 04.08.2010 dhe VKD nr. 1210, datë 31.03.2010, duke kërkuar ndërhyrjen e menjëhershme të AKEP, pasi mungesa e rregullimit po rezulton në konflikt të vazhdueshëm për lidhje të MI me Plus, si dhe mosshpallja e këtij të fundit OFNT, në tregun e terminimit në rrejtin përkatës ka legjitimuar indiferencën e Plus për të mos zbatuar vendimet rregullatore të AKEP;
16. Për sa më sipër AMC sh.a., në përputhje me përcaktimet në nenet 7, 31,34, 37, 39, 50, 60 dhe 120, të ligjit nr. 9918, dhe nenit 15, të Rregullores nr. 19, “Për aksesin dhe interkoneksionin”, si dhe VKD nr. 1531, datë 04.08.2010, kërkon që AKEP:
  - Të nxjerrë sa më shpejt një vendim që detyron operatorin Plus Communication sh.a., të zbatojë VKD nr. 1505, datë 10.02.2011;
  - Të nxjerrë urdhër në zbatim të nenit 60 të ligjit nr. 9918, për lidhjen e MI së re të interkoneksionit midis AMC sh.a. dhe Plus Communication sh.a., ku të pasqyrohen tarifat sipas vlerave dhe afateve të lartpërmendura dhe të zbatohen dispozitat e RIO-s së AMC sh.a..

### III. Sa më sipër, Këshilli Drejtues i AKEP, vlerëson se:

1. AKEP nëpërmjet Vendimit nr. 1351, datë 4.08.2010 “Për mbylljen e procedimit administrativ për zgjidhje mosmarrëveshje interkoneksioni të filluar me VKD nr. 1320, datë 28.06.2010 midis sipërmarrësve Mobil 4AL, Albtelecom sh.a, AMC sh.a, Eagle Mobile sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”, ka vendosur që:
  - a. Tarifa e terminimit të thirrjeve në rrjetin e Plus të jetë, 18.9 lek/min dhe 0.57 lek/thirrje;
  - b. Kjo tarifë të aplikohet në një afat maksimal deri më 31.08.2011;
  - c. Niveli i tarifave të terminimit për periudhat e mëpasshme, niveli i asimetrisë midis tyre dhe kohëzgjatja e saj do të përcaktohen me vendim të veçantë të AKEP, që do të merret në periudhën Shtator-Dhjetor 2010;
2. AKEP, me vendimin nr. 1469, datë 24.12.2010, miratoi nxjerrjen në konsultim Publik të dokumentit, “Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT” dhe në përfundim të procesit të konsultimit publik me Vendimin nr.1505, datë 10.02.2011 miratoi *Dokumentacionin Final për Orientimin në kosto të tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT*”, dhe me Vendimet nr.1506, 1507 dhe 1508, datë 10.02.2011 përcaktoi tarifat maksimale të terminimit të thirrjeve në rrjetet e operatorëve me FNT AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile;

3. Në dokumentin *Orientimi në kosto të tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT (dokumenti Final)*, të miratuar me Vendim nr.1505, datë 10.02.2011, AKEP gjithashtu ka dhënë tarifa rekomanduese për terminimin e thirrjeve në rrjetin Plus Communication për periudhën 1.03.2011-1.09.2015. Arsyeja e dhënies së tarifave rekomanduese dhe jo detyruese për Plus (si për tre operatorët e tjerë) është sqaruar në dokumentin e cituar, duke qënë se Plus nuk kishte ende (dhe nuk ka ende) status me FNT si tre operatorët e tjerë celularë. Në këtë dokument final, AKEP ka rishikuar nivelet e tarifave të terminimit të 4 operatorëve dhe asimetritë relative midis tyre, duke rritur kohëzgjatjen e asimetrisë nga 4 vjet në propozimin në konsultim publik në 5 vjet pas konsultimit publik;
4. Në kushtet kur Plus Communication nuk ka zbatuar tarifën e rekomanduar të AKEP për periudhën 1.03.2011-31.08.2011, duke kundërshtuar aplikimin e saj në negociatat me operatorët e tjerë, çka është bërë shkak për nisjen këtij procedimi administrativ dhe disa procedimeve të tjera, AKEP ka detyrimin të zgjidhë këtë mosmarrëveshje duke përcaktuar nivelin e tarifës për t'u aplikuar nga Plus, nivel i cili nuk do të jetë më rekomandues por detyrues për t'u zbatuar nga palët në mosmarrëveshje;
5. Në arsyetimin e Vendimit nr. 1351, datë 4.08.2010, AKEP morri në konsideratë midis të tjerave nivelin e asimetrisë së aplikuar në disa vende të tjera Europiane si Polonia, Norvegjia dhe Irlanda, sipas të dhënave të publikuara në dokumentin e BEREC (ish ERG) *BOR (10)30rev1: MTR Benchmark Snapshot (as of January 2010)*. Ndërkohë duke iu referuar të dhënave më të fundit, që i referohen situatës më 1.01.2011, të publikuara nga BEREC në dokumentin *BOR (11) 27 MTR benchmark snapshot\_110531: MTR Benchmark Snapshot (as of January 2011)*, niveli i asimetrisë së aplikuar në Irlandë, Norvegji dhe Poloni vazhdon të jetë i lartë në nivele 73-94%. Vlen të theksohet se operatorët më të rinj në këto vende (për të cilët vazhdojnë të aplikohen nivele të tilla asimetrie) kanë hyrë në treg ne vitet 2005-2006.
6. Sipas të dhënave të operatorit Plus Communication, niveli mesatar i përdorimit të shërbimeve nga pajtimtarët e këtij rrjeti është shumë i ulët dhe ARPU është në nivele shumë të ulëta në krahasim me operatorët e tjerë në treg. Këta tregues vlersohet se kanë lidhje me kushtet e tregut celular dhe kohën e hyrjes në treg te Plus Communication:
  - Plus communication filloi ofrimin e shërbimeve në fund të muajit Nëntor 2010 dhe në fund të vitit 2010 tregu celular arriti në 4.5 milion përdorues apo 140% normë penetrimi. Sipas të dhënave ndër vite, vlerësohet se tregu celular është afër nivelit të maturimit.
  - tregu celular në vitin 2010 dhe aktualisht është shumë më konkurrues se në vitet e mëparshme dhe sidomos me fillimin e viteve 2000, në kohën e hyrjes në treg të dy operatorëve më të mëdhenj. Ky nivel më i lartë konkurrence është refelktuar dhe në reduktime të tarifave të përdoruesve fundorë sidomos në politikat tarifore agresive të operatorëve me tarifa shumë të ulëta brenda grupeve, c'ka ka sjellë rritje të trafikut on-net dhe rënie të trafikut jashtë rrjetit. Kjo con në reduktim të efektit të asimetrisë aktuale në tarifatat e terminimit, pasi trafiku .
  - Niveli i lartë i penetrimit të shërbimeve celulare i shoqëruar me rritje të konkurrencës në tregun me pakicë, krijon një mjedis shumë të vështirë për hyrësin e ri në treg, Plus Communication, për rritjen e bazës së pajtimtarëve dhe aftësinë e



tij konkurrese në raport me lojtarët e tjerë në treg. Sic tregojnë të dhënat e Plus, pajtimatrët e këtij operatori janë përdorues shumë më të vegjël të shërbimeve se të operatorëve të tjerë.

7. Aplikimi i asimetrisë për hyrësit e rinj në treg rekomandohet për të krijuar mundësi operatorit të ri në treg që të konkurrojë me operatorët e tjerë që kanë krijuar një bazë të qëndrueshme pajtimtarësh dhe në kushte kur tregu është në maturim, konkurrenca është në nivel më të lartë dhe operatorët e tjerë kanë avantazhe më të mëdha në numër pajtimtarësh e përforcuar nga politikat tarifore agresive brenda-rrjeteve, aftësia e operatorit të ri për të konkurruar reduktohet ndjeshëm.
8. Niveli i tarifave rekomanduese të terminimit të thirrjeve në rrjetin Plus Communication dhe asimetrisë me tarifën e terminimit në rrjetet e tre operatorëve të tjerë celularë i dhënë në dokumentin *Orientimi në kosto të tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT (dokumenti Final)*, u konsiderua i arsyeshëm nga AKEP, duke gjykuar se aftësitë konkurrese të Plus do të rriteshin sidomos me implementimin e portabilitetit të numrit. Megjithatë, ecuria e tregut dhe karakteristikat e tij (te cituara më sipër), ku operatorët celularë janë fokusuar në konkurrencën me tarifën brenda rrjetit ka bërë që përdoruesit celularë të jenë më të intersuar për operatorët më të mëdhenj (me numër të madh përdoruesish) për të përfituar sa më shumë nga tarifën e ulëta brenda rrjetit. Në këto kushte Plus duket se ka pasur më shumë largime nga rrjeti se operatorët e tjerë, e lidhur kjo dhe me një cilësi të lartë të shërbimit për portimin e numrit nga Plus (Plus ka koeficientin më të lartë të suksesit për procedimin e kërkesave për portime jashtë rrjetit, duke demonstruar zbatueshmëri të lartë të detyrimeve rregullatore).
9. Për sa më sipër me qëllim mbrojtjen e konkurrencës në treg dhe interesave të përdoruesve fundorë në periudhë afatgjatë, tarifa e terminimit të thirrjeve në rrjetin Plus Communication të vazhdojë të jetë në të njëjtin nivel siç është përcaktuar në Vendimin nr. 1351, datë 4.08.2010, deri në përcaktim të mëvonshme të AKEP për këtë tarifë, në varësi të rezultateve të analizës së rradhës së tregut, sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 34 të ligjit 9918.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brëndshme,

## **V E N D O S:**

1. Të mbyllë procedimin administrativ të filluar me VKD nr. 1616, datë 24.06.2011 “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Albanian Mobile Communications sh.a dhe Plus Communication sh.a.;
2. Tarifa e terminimit të thirrjeve në rrjetin Plus Communication sh.a të vazhdojë të jetë 18.9 lek/minutë dhe 0.57 lek/thirrje, deri në një vendim tjetër të AKEP.

3. Të njoftohen palët e interesuara Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Plus Communication sh.a. për mbylljen e procedimit administrativ;
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**  
**Piro XHIXHO**

**ANËTARË:**

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**